



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeño / Prodato Received / Delivery	23 . 09	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedimica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRINYSHICK	5654/2022		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.615/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca - anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.698/2021 të 29.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.428/2020 të datës 21.12.2020 të parashtruar nga ankuesja, nga në Komunën e Kamenicës, kundër organit të punësimit Komuna e Kamenicës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 23.09.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËRFUNDON PROCEDIMI administrativ** i filluar ma ankesën me numër A.nr.428/2020, e datës 21.12.2020 e parashtruar nga ankuesja

**A r s y e t i m**

Ankuesja më datë 21.12.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me kërkesë që t'i ndryshohet statusi nga nëpunës civil në nëpunës publik. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 18.02.2021 ka nxjerr Vendim A.nr. 428/2020, me të cilin ka bërë përfundimin e procedimit administrativ të inicuar sipas ankesë së ankueses.

Ankuesja e pakënaqur me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka hapur konflikt administrativ, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 29.06.2022ka nxjerr Aktgjykim A.nr. 698/2021, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke e anuluar Vendimin A. nr. 428/2020, të datës 18.02.2022, duke e kthyer çështjen në rishqyrtimin dhe rivendosje tek Këshilli.

*Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto;* Ankesën A.nr. nr.615/2022, e datës 14.07.2022, sipas Aktgjykimit të 29.06.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative ; përgjigje në padi e datës 13.05.2022; Aktvendim i datës 05.04.2022, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Padi e datës 29.03.2021, drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Vendimi A. Nr. 428/2020, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokollit 3240/2020 të datës 21.12.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në kërkesë e datës 16.11.2020; Vendimi për pezullimin e marrëdhënies së punës së ankueses i datës 28.08.2019; Emali zyrtar i datës 17.04.2019; Kërkesa e datës 23.10.2020; Pliko postare R 1306391; Kërkesa për përgjigje e datës 24.12.2020; Përgjigja në kërkesës e datës 08.01.2021; Vendimi i KPMSHCK-se për vazhdimin e afatit i datës 04.02.2021; Emali i datës 03.02.2021; Emali zyrtar i datës 14.01.2021; Emali zyrtar i datës 10.02.2021 se bashku me tabelën-listën e klasifikimit të zyrtareve që Zyra e Personelit – Komuna e Kamenicës e ka dërguar në MPB për deklarim të statusit të zyrtareve publike; Akt emërimi i ankueses i datës 06.08.2019; Emali zyrtar i datës 18.02.2021 dërguar nga Zyra të Personelit te Komunës se Kamenicës .

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesja ashtu edhe nga organi i punësimit ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses është bërë i pamundur, *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, fillimisht ka analizuar Aktgjykimin me numër A.rr.698/2021 të datës 29.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me të cilin aktgjykim ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit duke e anuluar Vendimin me numër A. nr. 428/2020, të datës 18.02.2022, duke e kthyer çështjen në rishqyrtimin dhe rivendosje tek Këshill.

Këshilli në pajtim me obligimin e gjykatës, e ka marr në rishqyrtim lëndën, dhe për konstatimin e saktë të gjendjes faktike dhe juridike ka shqyrtuar provat e lëndës, të pranuar nga organi i punësimit, respektivisht Zyra e Personelit nga Komuna e Kamenicës e cila me datë 10.02.2021 dhe 18.02.2021 përmes e-mailit ka njoftuar se Komuna e Kamenicës me datë 17.11.2020 e ka dërguar listën–tabelën me të gjithë të punësuarit e kësaj komune për deklarim të statusit të zyrtarëve publike në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Po ashtu në emalin e datës 10.02.2021 Komuna e Kamenicës ka bashkangjitur listën e emërtuar „klasifikimi i punëtorëve”, e cila liste është dorëzuar në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku në këtë listë është përfshirë edhe ankuesja Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit ka konstatuar se institucioni punëdhënës e ka dërguar listën për deklarim të statusit të zyrtarëve publikë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në pajtim me të Rregulloren (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme pas pranimit të dokumentacionit përkatës nga institucionet e administratës shtetërore është e obliguar që të vendos për *deklarimin e statusit të punësimit* në përputhje me nenin 4 paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e



Statusit të Zyrtarëve Publikë, ndërsa kundër vendimeve për deklarimin/rregullimin e statusit, mund të parashtrohet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në pajtim me nenin 8 të Rregullore (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: „Kundër vendimeve për deklarimin/rregullimin e statusit, sipas kësaj Rregullore mund të parashtrohet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ në pajtim me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative”, rrjedhimisht nga kjo ankueses i njihet e drejta për ankesë në rast se ajo konsideron se i janë shkelur të drejtat e saj pas deklarimit të statusit të punësimit nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Në kuptim të dispozitave të lartcekura, rrethanave të lartpërmendura dhe dëshmimeve të ofruara nga organi i punësimit, Kolegji konstaton që objekti ankimor i filluar me ankesën e ankueses është bërë i pamundur në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku është përcaktuar që “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”, rrjedhimisht sipas Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që janë plotësuar kushtet për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën e parashtruar nga ankuesja.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.615/2022**

*Rushit KAJTAZI*

*Procesmbajtës*

*Malsore GASHI BAJRAKTARI*

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses,
- Gjyqtares
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kamenicës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

*në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje*

